



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina


Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, merr këtë

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E INSTITUCIONIT**  
**PARASHKOLLOR NË FSHATIN BUSI - PRISHTINË**

1. Miratohet caktimi i lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi - Prishtinë.
2. Lokacioni nga pika 1 e këtij vendimi, gjendet në kuadër të Planit zhvillimor komunal, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 031-156871, dt. 27.08.2013 (*parcela e propozuar për ndërtimin e Institucionit parashkollor sipas Planit zhvillimor komunal, shtrihet në zonë të destinuar për banim individual*), parcela kadastrale nr. 02304-0, ZK Busi (*ka sipërfaqe kadastrale prej 40 arë*, pronësia e parcelës nr. 02304-0, ZK Busi, është pronë komunale "PSH, Komuna e Prishtinës").
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi dhe ekstrakti nga PZHK-ja.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Kadastrit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-353/02-134258/23, më 29.06.2023

KRYESUES I MBLEDHJES SË KUVENDIT  
AJET BRAJSHORI



## ARSYETIM

### I Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi - Prishtinë

Në bazë të takimeve të zhvilluara ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, por edhe duke u bazuar në kërkesat dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike, është arritur dakordimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi në Prishtinë.

Drejtorja e Planifikimit Strategjik, sipas kërkesës së lartcekur, ka identifikuar lokacionin për ndërtimin e IP-së, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor komunal, i miratuar me Vendimin e KK-së së Prishtinës, 01. nr. 031-156871, dt. 27.08.2013 (*parcela e propozuar për ndërtimin e Institucionit parashkollor sipas Planit zhvillimor komunal, shtrihet në zonë të destinuar për banim individual*), parcela kadastrale nr. 02304-0, ZK Busi (*ka sipërfaqe kadastrale prej 40 arë, pronësia e parcelës nr. 02304-0, ZK Busi, është pronë komunale "PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë"*).

Gjatë hartimit të projekti duhet të trajtohet dhe inkorporohet edhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 02305-0, ZK Busi, e cila shtrihet përgjatë rrugës kryesore. Kjo shtrirje do t'i mundësonte objektit qasje më të lehtë dhe organizimi i projektit do të ishte më funksional.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se në kuadër të parcelës nuk ka ndërtesa ekzistuese, terreni i parcelës ka një pjerrtësi të lehtë në drejtimin jug-lindje, ndërsa qasja në parcelë është përmes rrugës kryesore të fshatit Busi.

Duke pasur parasysh që Plani zhvillimor komunal aktual nuk i ka të përcaktuara objektet për shërbime komunale në nivel të fshatrave, gjatë procesit të hartimit të Planit zhvillimor komunal dhe Hartës zonale, Komuna këto dy parcela do t'i harmonizojë me dokumentet e planifikimit të cilat janë në proces të hartimit.

#### **Bashkangjitur:**

- skica e lokacionit të propozuar,
- ekstrakti nga plani zhvillimor urban,

- Lokacioni i propozuar.



- Pjesa grafike nga Plani zhvillimor komunal.

